



# AKTIVITETET E SHTATORIT

Kalina S. Andonova

Olimpiada e njëzetetë republikane e pensionistëve për sport dhe shoqërim, aktiviteti më i vjetër dhe më masovik programor i pensionistëve në Lidhjen e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, është mbajtur për nder të 8 shtator, Ditën e pavarësisë së Republikës së Maqedonisë dhe 20 shtator – Ditën e pensionistëve në vendin tonë.

Në Olimpiadë i pari të pranishmëve ju drejta kryeministri i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Zoran Zaev. Në fjalimin e tij, ai përshëndeti energjinë që kanë pensionistët dhe i porositi se kujdesi dhe mbrojtja mbeten prioriteti kryesor i Qeverisë dhe u shpreh:

“Po përcjellim praktikat evropiane, shohim si jetojnë pensionistët në vendet e Bashkimit Evropian, në mënyrë më të qetë dhe më komode, prandaj edhe hapat strategjike të cilat po i ndërmarrim çojnë pikërisht drejt Bashkimit Evropian. Ato hapa janë që të ngrihim standardin në nivel të dinjitetshëm ashtu siç i ka hije secilit, atij që në mënyrë të ndershme ka punuar gjatë viteve të tij produktive, dhe duhet t'i shijojë ditët e pensionimit në mënyrë të rregullt dhe me krenari.

Ministrja e punës dhe politikës sociale, Milla Carovska tha se me organizimin e evenimenteve të



ndryshme me karakter social, kulturor dhe sportiv, Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë kontribuon që të përmirësohet statusi i tyre. Ajo i porositi që Ministria me përkushtim punon në sigurimin e kushteve më të mira për jetë të dinjitetshme të këtyre qytetarëve, të cilët me përvojën e tyre jetësore që e kanë janë një hallkë e rëndësishme e shoqërisë.

–Maqedonia është shtet social e cila kujdeset për qytetarët përmes sigurimit social dhe qasje deri te të drejtat sociale. Qëllimi kryesor i kësaj qeverie është që sa më mirë t'i avancojë dhe përmirësojë këto të drejta me çka do të përmirësojë standardin e pensionistëve dhe do t'u sigurojë jetë të dinjitetshme dhe të qetë. Prandaj ashtu siç rriten rrogat, rriten edhe pensionet dy herë në vit.

Fjalimi i kryeministrit dhe ministres u përcollën me duartrokitje nga të pranishmit të nderuar me fjalimet e tyre të rastit dhe me fjalët e bukura.

Në emër të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë të pranishmëve ju drejtua Salltir Karovski, nënkryetari i KE të LSHPM i cili theksoi:

–Ndjej nder të veçant që mund në emër të LSHPM sot në Radovish në këtë manifestim të bukur sportiv t'ju përshëndes me të vetmin qëllim avancim, pasurim dhe zgjerim të interesit dhe motivimit të pensionistëve për praktikim të aktiviteteve sportive për mirëmbajtje të aktivitetit dhe kondicionit të tyre psikofizik.

Në mënyrë të posaçme dëshiroj të shpreh kënaqësinë time, besoj edhe të juajën që sot në këtë

mbledhimin tonë, na nderuan me prezencën e tyre personale kryeministri Zoran Zaev dhe ministrja Milla Carovska, duke treguar mbështetje të sinqertë për Lidhjen si asociacion joqeveritar, jopartiak dhe multietnik të pensionistëve.

Mysafirët e pranishëm, sportistët dhe adhuruesit e sportit i përshëndeti edhe kryetari i Komunës së Radovishit, Gerasim Konzullov dhe kryetari i Komunës Konçe, Bllagoj Iliev i cili mes tjerash theksoi se janë të nderuar që LSHPM u dha besim SHP Radovish dhe Konçe të jenë nikoqirë të garave të 23-ta sportive republikane të pensionistëve dhe premtuan që komunat çdoherë do t'i ndihmojnë aktivitetet e pensionistëve sepse atë ata e meritojnë.

Jordan Kostadinov, kryetari i SHP Radovish dhe Konçe, shoqata e cila këtë vit është edhe nikoqir i kë-

tij manifestimi masovik, u dëshiroi mirëseardhje të pranishmëve, ndërsa sportistëve rezultate të mira.

Para një numri të madh adhuruesish të sportit dhe fansave, në 11 disiplina në konkurrencën e meshkujve dhe femrave, në 23 kategori garuan 503 sportistë, 264 pensionistë dhe 239 pensioniste nga 43 shoqatat anëtare të LSHPM, të cilët me rezultate e tyre në garat sportive rajonale garuan për pjesëmarrje në këtë manifestim sportiv më masovik në Republikën e Maqedonisë.

Në fund të garave u shpallën edhe sportistët më të mirë individual në tri disiplina: shenjëtari, shah dhe pikado në konkurrencën e femrave dhe meshkujve, të cilëve kryetari i Komisionit për sport dhe rekreacion pranë LSHPM, Zdravko Petkovski u dorëzoi kupa të posaçme. Garat përfunduan me dorëzimin e kupës fituesve nga SHP Tetovë në festën e përbashkët. Me urime për suksesin e arritur, kupën e dha nënkryetari i KE të LSHPM Salltir Karovski, i cili mes tjerash tha:

–Edhe këtë herë dëshmuat se sporti është shumë i rëndësishëm për njerëzit e gjeneratës së tretë dhe se me praktikumin e tij përforcojmë shëndetin tonë fizik dhe psikik. Përfundoi Olimpiada e 23-të, e cila ishte olimpiadë e sportit, shoqërimit dhe bashkëjetesës. Ashtu të bashkuar dhe shoqëruar të vazhdojmë edhe në të ardhmen në olimpiadat në vijim.

I mahnitur nga fitorja kryetari i KE të shoqatës së Tetovës, Shaban Azizi me fjalët më të mira ju falënderua garuesve të cilët me duartrokitje përshëndetën suksesin e madh dhe ju gëzuan fitores.

## SHP TETOVË, TAKIM ME FEJZI RUSTEMI – DODO

# ÇMIMET DHE MIRËNJOHJET PENSIONALE – MË TË DËSHIRUARAT

Cjoko Eftoski

Pensionisti Fejzi Rustemi për ata që dëshirojnë ta takojnë, do të mund ta gjejnë në klubin e Shoqatës së pensionistëve të Tetovës. Një pjesë bukur të mirë të kohës e kalon atje, me shokët dhe miqtë e tij, me moshatarët, me ata, të cilët vazhdimisht luan, posaçërisht domino. Nëse e kërkon me emër dhe mbiemër, më të afërmit e tij mund të ngritin krahët me shenjë “se nuk e njohin”. Të gjithë e njohin atë si Dodo, njeri i cili shoqërohet dhe bën shaka, që i trimëron moshatarët e tij të gjeneratës së tretë, kolegët e tij – pensionistë.

Dodo ka më pak se gjashtë vjet të plota stazh pensional. Gjatë gjithë këtyre viteve ai është në sho-

qatë, posaçërisht në mesin e atyre që preokupim e kanë lojën – domino. Brenda këtyre viteve sa është pensionist, ka marrë pjesë në aq gara sportive të pensionistëve. Bilanci i tij sportiv është vërtetë mahnitës. Në pesë takimet e deritanishme rajonale, pesë herë ka qenë i pari, ndërsa në katër pjesëmarrje në garat sportive rajonale, dy herë gjoksin e tij e ka stolitur me medalje të artë. Mirënjohje dhe diploma ka nga të gjitha garat e deritanishme sportive rajonale dhe republikane. Ai është optimist edhe për më tutje. Jo vetëm që thotë se do të radhisë pllakat e domino-lojës, por vazhdimisht do të sulmojë në vende sa më të larta.

–Domino nuk është një lojë e thjeshtë ku vetëm radhiten domi-

no pllakat, sipas përshkrimit të një gjysme të njerëzve. Në atë radhitje dhe rend ka shumë variante. Nuk do të thotë se nëse ke vend të lirë, dhe ke në dorë pllakën e duhur, atë edhe duhet ta bësh. Është shumë me rëndësi të dishë se si të “bllokosh” kundërshtarin, të mos lejosh që ai të “zbracet” dhe të dalë fitues. Unë konsideroj që jam futur thellë në lojën e dominos dhe do të vazhdoj të përsosë këtë sistem të lojës dhe të fitoreve, thotë i popullarizuar Dodo.

Në biografinë e Fejziut thuhet se më shumë se 30 vjet ka kaluar si i punësuar në “Interpromet”, deri në momentin kur ka marrë vendimin si “tepricë teknologjike”. Situatat e tillë e detyroi atë të hapë një shitore private kryesisht për kon-

feksion të lehtë, ndërsa ai ka qenë angazhimi i tij në ndërmarrje. Ai ka qenë i dashur në mesin e punëtorëve, të cilët edhe sot e vizitojnë në shitoren e tij “Tregu i masllarëve” në Tetovë. Nëse e pyetet për çmimet dhe mirënjohjet, do të thotë se më të dashurat dhe më të dëshiruara i ka ato të fituara me pensionistët. Në të kaluarën, punëtorët e “Interpromet”, si të vyesëm dhe të respektueshëm, Dados i kanë ndarë banesë, duke i ndihmuar që të zgjidhë përgjithmonë çështjen e banimit, për çka u është tepër mirënjohës.

Për ndryshe, përveç në sport, Fejzi Rustemi ka marrë pjesë edhe në aktivitete tjera rekreative të cilat i organizon SHP Tetovë. Ai thotë se duke marrë pjesë në shëtitjet



dhe ekskursionet, ka vizituar shumë vende të shtetit, duke u njohur me vlerat kulturore dhe historike në destinacionet ku ka udhëtuar. Jo vetëm në Maqedoni, Dodo ka vizituar edhe shumë rajone dhe vende në Bullgari, Serbi, Kosovë dhe Shqipëri.